



Procedurë votimi për zgjedhjen e Guvernatorit/es së emëruar përcaktuar DGND (2027-2028) për Distriktin 2485 të Rotary International

Gjakove, 02.01.2025

Mbështetur në Aktet nënligjore të Rotary International (RI) 12.020. *Procedura për të Zgjedhur Guvernatorin/en dhe vendimi i Konferencës së Distriktit në Tiranë më 16.06.2024, procedura që do të ndiqet për të emëruar guvernatorin/en është "Vota e Klubit".* Parimi i rotacionit për guvernatorë, një vit nga Kosova dhe një vit nga Shqipëria, u miratua gjatë Konferencës së Distriktit. **Bazuar në këtë, Guvernatori/ja 2027 – 2028 do të jetë anëtar i një klubi në Shqipëri, por i votuar nga të gjitha klubet nga Shqipëria dhe Kosova.**

Më poshtë jepen kërkesat e Akteve nënligjore të RI:

12.040. *Zgjedhja e Guvernatorit/es me Votën e Klubit*

Guvernatori/ja do t'i dërgojë çdo klubi një thirrje zyrtare për kandidatura për guvernator. Të gjitha kandidatimet duhet të bëhen me shkrim, të nënshkruara nga presidenti/ja dhe sekretari/ja i klubit dhe të mbërrijnë tek guvernatori/ja brenda afatit të caktuar. Afati do të jetë të paktën një muaj pas thirrjes për kandidime. Një klub do të sugjerojë vetëm një nga anëtarët e vet.

Duke marrë parasysh sa më sipër:

1. Unë ftoj të gjithë klubet të fillojnë procedurën e nominimit me 03 janar 2025 dhe të më dërgojnë kandidaturën e tyre për guvernatorë/e jo më vonë se 03 shkurt 2025. Vendimi duhet të merret gjatë një takimi të zakonshëm të klubit me kuorumin e përcaktuar nga rregullorja e klubit (30% e anëtarëve). Kandidaturat duhet të dërgohen tek butrint@inovaconsulting.eu dhe Sekretarja e Distriktit district.2485@gmail.com. Kandidatura duhet të shoqërohet me CV rotariane dhe profesionale të kandidatit dhe deklaratën nga Rregulloret e RI, 16.010. (e).
2. Rotarianët e kandiduar duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) 16.010. Cilësitë e një guvernatori të emëruar.

Nëse nuk është vendosur ndryshe nga këshilli drejtues, personi i zgjedhur si guvernator i emëruar në kohën e përzgjedhjes do të:

(a) jetë anëtar me emër të mirë i një klubi funksional në distrikt;

(b) ketë shërbyer si president klubi për një mandat të plotë apo si president themelues për të paktën gjashtë muaj;

(c) demonstrojë gatishmëri, përkushtim dhe aftësi për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e një guvernatori në pikën 16.030.;

(d) demonstrojë njohuri për cilësitë, detyrat dhe përgjegjësitë e guvernatorit siç përshkruhen në rregulloret; dhe

(e) paraqes për RI një deklaratë që Rotariani/ja i kupton ato cilësi, detyra dhe përgjegjësi, është i/e përgatitur për detyrën e guvernatorit dhe është i/e gatshëm dhe i/e aftë të marrë përsipër dhe të ushtrojë me besnikëri ato detyra dhe përgjegjësi. (bashkangjitur)

b) Kërkesat e tjera:

(a) Të komunikojë (me gojë dhe me shkrim) në një gjuhë komunikimi të Rotary International (parapëlqehet gjuha angleze)



- (b) Të demonstrojë një veprimtari të mëparshme në leadershipin e distriktit apo në BKRSH dhe KKRK.
- Orari i procedurës është i bashkangjitur dhe është bërë sipas udhëzimeve të marra nga zyra e Rotary International në Cyrih, për Mbështetje të Klubeve dhe Distriktit.
 - Më 04 shkurt 2025, do të verifikoj me Komitetin e Distriktit nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat dhe do të njoftoj të gjitha klubet e Distriktit kush janë kandidatët.
 - Më 05 shkurt 2025, unë do të njoftoj të gjitha klubet e rrethit se sa vota kanë në bazë të faturave të RI-së më 1 korrik 2024.
 - Do të nis procedurën e votimit online për klubet duke përdorur [SimplyVoting](#) më **20 shkurt 2025 e cila do të përfundojë më 08 mars 2025**. Do të njoftoj edhe vendin ku do të numërohen votat pas konsultimeve me DGE, që do të kthehet nga Asambleja Ndërkombëtare.

Kjo procedurë pranohet nga Kushtetuta Ndërkombëtare e Rotary:

Neni 14 Interpretimi

Përmes kësaj kushtetute, aktet nënligjore të RI-së dhe kushtetutën standarde të klubit, fjalët "do", "është" dhe "janë" janë të detyrueshme dhe fjalët "mund" dhe "duhet" janë lejuese. Terminologjia "postë", "email", "votim me postë" dhe "votim në klub" do të përfshijë përdorimin e postës elektronike (e-mail) dhe teknologjisë së internetit për të ulur kostot dhe për të rritur reagimin.

- Procedura e votimit do të zhvillohet nga data **20 shkurt 2025 e cila do të përfundojë më 08 mars 2025**. Klubet do të marrin listën me kandidatët, të renditur sipas rendit alfabetik. Lista do të shoqërohet me CV-në Rotariane dhe profesionale të të gjithë kandidatëve (Sipas nenit 12.050. të akteve nënligjore të RI, klubeve u jepet të paktën 15 ditë për të kthyer fletët e votimit dhe intervali i mësipërm mbulon këtë kërkesë)
- Gjatë një mbledhjeje të zakonshme të klubit, duke pasur kuorumin (30% të anëtarëve), të gjitha klubet do të votojnë një kandidat të propozuar nga klubet e Shqipërisë. Vendimi i klubit do të merret me 50% +1 të anëtarëve të pranishëm. **Presidenti do të transferojë fletën e votimit, online duke përdorur platformën SimplyVoting, përpara anëtarëve të klubit.** Në këtë mënyrë do të shmangen ankesat e mëtejshme të mundshme në lidhje me votën e klubit.
- Fleta e votimit do të merret nga komisioni i votimit, i cili do të numërojë votat më **09 mars 2025**, në vend të zgjedhur në koordinim me DGE, ku do të bëhet mbledhja e Komisionit të Distriktit. Kandidatët apo përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë në procesin e numërimit të votave.

Anëtarët e komisionit të votimit janë:

- Sabahet Lishi – Asistent Guvernatore
- Ismajl Baftijari – Asistent Guvernator
- Fleta Baraku – Sekretare e Distriktit



12.050.2. Komisioni i Votimit. Guvernatori do të njoftojë vendin, datën dhe orën për numërimin e votave dhe do të caktojë një komision votimi prej tre anëtarësh. Konfirmimi i votave do të bëhet veçmas numërimit të votave. Komisioni do të marrë masa për të ruajtur sekretin e votave dhe për të lejuar kandidatët apo përfaqësuesin e një kandidati të jetë i pranishëm për të vëzhguar numërimin e votave.

Votat do të numërohen sipas akteve nënligjore të RI, neni. 12.050.1. Faturat në 1 korrik 2024 do të përcaktojnë anëtarësinë e çdo klubi dhe numrin e votave të tij.

12.050.1. Votimi në klub. Numri i votave të klubit përcaktohet nga formula në nënpikën 15.050.1., bazuar mbi faturën e klubit të datës 1 korrik. Nëse një klub ka të drejtën për më shumë se një votë, klubi do t'i hedhë të gjitha votat për të njëjtin kandidat. Emri i kandidatit për të cilin klubi ka hedhur votën(votat) e tij do të verifikohet nga sekretari dhe presidenti i klubit dhe do t'i përcillet guvernatorit.

15.050.1.....Një klub me më shumë se 25 anëtarë ka një zgjedhës shtesë për çdo 25 anëtarë shtesë Pra, një klub me anëtarësi deri në 37 anëtarë ka të drejtën e një zgjedhësi, një klub me 38 deri në 62 anëtarë ka të drejtën e dy zgjedhësve, një klub me 63 deri 87 anëtarë ka të drejtën e tre zgjedhësve e kështu me radhë. Anëtarësia përcaktohet nga numri i anëtarëve në faturën **më të fundit të klubit përpara votimi**; një klub i pezulluar nuk ka votë.

Sipas akteve nënligjore të RI, neni. 12.050.3, komisioni i votimit do të raportoj menjëherë rezultatet tek unë, duke treguar se sa vota ka marrë secili kandidat.

Unë do të shpall rezultatet e votimeve më **10 mars 2025** dhe do të dorëzoj emrin e të Emëruarit/es së Përcaktuar për Guvernatorin/en e Distriktit të caktuar në CDS në Cyrih më **17 mars 2025**.

Dua të nënvizoj klauzolat e nenit:

13.010. Ushtrimi i ndikimit në fushatë zgjedhore

Në mënyrë që rotarianët më të mirë përgatitur të përzgjidhen për pozicione që fitohen me anë të zgjedhjeve në Rotary International, çdo orvajtje për të ndikuar procesin përzgjedhës për një pozicion të tillë, në çfarëdo mënyre, duke përfshirë ushtrimin e ndikimit në fushatë zgjedhore, është i ndaluar. Rotarianët nuk do të bëjnë fushatë për t'u zgjedhur në pozicione që fitohen me zgjedhje në RI apo të lejojnë veprimtari të tillë, për veten e tyre apo të tjerë. Nëse nuk është autorizuar shprehimisht nga bordi, ky ndalim përfshin çfarëdo shpërndarje apo qarkullim nga vetë apo të tjerë të broshurave, literaturës, letrave, materialeve, medias elektronike apo komunikime të tjera ndaj çfarëdo klubi apo anëtarë të klubeve. Nëse një kandidat mëson për ndonjë veprimtari të ndaluar, ata (rotarianët) do të shprehin aty për aty mosaprovim dhe do të udhëzojnë që veprimtaria të ndërpritet.

Ftoj të gjithë rotarianët në Shqipëri - Kosovë të ruhen nga ndonjë veprimtari e tillë gjatë procedurës së kandidimit në klub, duke lejuar një process korrekt emërimi dhe duke shmangur ankesa që e dëmtojnë procesin.